



Në bazë të nenit 7, alineja 9 e Ligjit për themelimin të Agjencisë për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural ("Gazeta Zyrtare" e Republikës së Maqedonisë numër 72/2007 dhe 5/2009), Agjencia për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural në vijim publikon

**THIRRJE PUBLIKE nr. 07/2013**

**Për dorëzimin e kërkesave për shfrytëzim të mjeteve nga Programi për përkrahje financiare të zhvillimit rural për vitin 2013**

**I. LËNDA E SHPALLJES**

Lëndë e kësaj shpallje është ndarje e përkrahjes financiare për masat në vijim:

<i>Grupi i masave</i>	<i>Ndihmë për mbrojtjen e rajoneve rurale dhe karakteristikat e tyre tradicionale</i>	<i>Vlera maksimale e shpenzimeve të pranueshme (deri më)</i>
Masa 213	<p>Kompensimi i shpenzimeve për mirëmbajtjen e kullosave vendeve malore dhe livadheve dhe përkrahje e blegtorisë tradicionale</p> <ul style="list-style-type: none"><li>- në shumë prej 80% nga shpenzimet për ruajtjen dhe kullotjen e bagëtisë (dhen, dhi dhe/ose lopë) në kullosa (duke përfshirë edhe livadhet) që gjenden në vendet e banuara me lartësi mbidetare më të lartë se 700 metra, gjegjësisht vendet e regjistruara për ruajtje ku ruhet bagëtia të gjenden në vendbanime me lartësi mbidetare më të lartë se 700 metra dhe</li><li>- në shumë prej 40% të shpenzimeve për ruajtje dhe kullotje të bagëtisë (dhen, dhi dhe/ose lopë) që gjenden në vendet e banuara me lartësi mbidetare nën 700 metra, gjegjësisht vendet e regjistruara për ruajtje ku ruhet bagëtia të gjenden në vendbanime me lartësi mbidetare më të lartë se 700 metra</li></ul>	<ul style="list-style-type: none"><li>- Jo më shumë se 300.000 denarë për person të punësuar për jo më shumë se 20 persona të punësuar</li><li>- Për mbi 10 persona të punësuar ndihma zvogëlohet për 50%</li></ul>
Kriteret	<ul style="list-style-type: none"><li>- Përkrahja ndahet në raport me:</li><li>- 1 person të punësuar për 150 dhen</li><li>- 1 person të punësuar për 50 dhi</li><li>- 1 person të punësuar për 80 lopë</li></ul> <p>Numri i personave të punësuar për të cilët paguhet përkrahja duhet të jetë i njëjtë në periudhë prej së paku një vit para vitit për të cilën është lejuar dhe paguar përkrahja</p>	

**II. TË DREJTË PËR SHFRYTËZIMIN E MJETEVE**

Të drejtë për shfrytëzim të mjeteve kanë subjektet në vijim:

<i>Subjektet</i>	<i>Masa</i>
Ekonomitë bujqësore të regjistruara në pajtim me Ligjin për bujqësi dhe zhvillim rural në Regjistrin e vetëm të ekonomive bujqësore pranë Ministrisë së bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave	213

**III. KUSHTET PËR SHFRYTËZIMIN E MJETEVE DHE DOKUMENTACIONI I CILI DUHET TË DORËZOHET**



Kërkesat për masë të veçantë dorëzohen në kopje origjinale.

Kushtet të cilat duhet ti plotësojnë kërkesit e mjeteve janë të përcaktuara me:

- Programin për përkrahje financiare të zhvillimit rural për vitin 2013 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 5/2013, 81/2013, 155/2013 dhe 181/2013)
- Ligjin për bujqësi dhe zhvillim rural ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 49/2010, 53/2011, 126/2012, 15/2013, 69/2013 dhe 106/2013)

Nëse deri në Agjenci dorëzohen më shumë kërkesa sesa ka mjete të disponueshme për masën 2013, në pajtim me Programin për përkrahje financiare të zhvillimit rural për vitin 2013, Agjencia do tu japë përparësi atyre kërkesave të cilët kanë dorëzuar kërkesën e tyre më herët se të tjerët.

Një kërkesues mund të dorëzojë një kërkesë vetëm për një masë. Një kërkesues mund të shtrojë më së shumti 2 kërkesa veç e veç për masa të ndryshme duke marrë parasysh edhe masat e tjera nga programi për zhvillim rural për vitin 2013.

#### IV. MARRJA E FORMULARËVE DHE UDHËZIMEVE

Formularët "Kërkesë për pagesë" me listën e dokumenteve të nevojshme mund të merret në ueb faqen e Agjencisë [www.ipardpa.gov.mk](http://www.ipardpa.gov.mk).

Formularët e lartpërmendur mund të merren edhe në mënyrë të drejtpërdrejtë në Agjenci çdo ditë pune prej ora 8:30 deri në ora 16:30 në adresë:

**Agjencia për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural,  
Bul. "3-ta Makedonska Brigada" nr. 20  
(ndërtesa e Makedonija Tabak blloku C)  
1000 Shkup**

#### V. MËNYRA E DORËZIMIT TË DOKUMENTEVE

Kërkesat e plotësuara për shfrytëzim të mjeteve dhe kërkesat për pagesë nga Programi për përkrahje financiare për zhvillim rural për vitin 2013 së bashku me dokumentacionin e tërësishëm të nevojshëm dorëzohen në gjuhën maqedonase në zarf të mbyllur me shënim në këndin e majtë lart të anës së përparme të zarfit "MOS HAP" për Thirrjen publike nr. 05/2013 dhe shënimin e shifrës së masës për të cilën dorëzohet kërkesa. Kërkesa mund të dorëzohet përmes postës ose personalisht në arkivin e Agjencisë, në të kundërtën Agjencia nuk merr përgjegjësi për arritjen jo në kohë ose të pakompletuar apo hapjen e parakohshme të kërkesës.

**Afati i fundit për dorëzimin e kërkesave është 15.01.2014. Kërkesat e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk do të merren parasysh.**

Informata më të detajuara në kontakt tel. (02) 3097-460 ose në kontakt e-mail adresën: [ipardpa.info@ipardpa.gov.mk](mailto:ipardpa.info@ipardpa.gov.mk) dhe ueb faqen: [www.ipardpa.gov.mk](http://www.ipardpa.gov.mk).

Kontakt:

Agjencia për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural, Sektori për lejim të projekteve. Dhe Sektori për lejim të pagesave.

Telefon 02 3097 - 460, çdo ditë pune prej ora 08.30 deri në ora 16.30

e-mail: [ipardpa.info@ipardpa.gov.mk](mailto:ipardpa.info@ipardpa.gov.mk)